



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 116 dt.22.09.1995

PER
PAJISJEN E TEATRIT TE KUKULLAVE ME BAZEN E NEVOJSHME
MATERIALE PER ZHVILLIMIN E FESTIVALIT BALLKANIK SI
DHE TE SALLES SE TEATRIT TE VARIETESE ME KARRIKE.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Kulturës dhe ai i Financës “Për paisjen e Teatrit të Kukullave me bazën e nevojshme materiale për zhvillimin e Festivalit Ballkanik si dhe të sallës së Teatrit të Varietesë”, në mbështetje të nenit.14, të Ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”,

VENDOSI

1. Ti akordohen Teatrit të Kukullave një fond prej 700.000 lekësh për blerjen e materialeve të ndriçimit, pajisje skene, salle dhe orendi të ndryshme.
2. Ti akordohet Teatrit të Varietesë një fond prej 500.000 lekësh për blerjen e karrikeve për sallën.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Seksioni i Kulturës, Teatri i Kukullave dhe ai i Varietesë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA